



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 qershor 2023
Nr. ref.: AGJ 2218/23

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI82/22

Parashtrues

Valon Loxhaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme
Rev.nr.103/2022 të 30 marsit 2022**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Valon Loxhaj nga komuna e Istogut (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit Rev. nr. 103/2022 të 30 marsit 2022 të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në ndërlidhje me Aktgjykimin Ac. nr. 504/2019 të 13 tetorit 2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimit [C.nr.1507/16] të Gjykatës Themelore në Prishtinë të 22 tetorit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 103/2022 të 30 marsit 2022 përmes të cilit sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 qershor 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 23 qershor 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit nr. GJR. KI82/22 caktoi gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 24 qershor 2022, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
8. Më 30 shtator 2022, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë që ta dorëzon dosjen e plotë të kërkesës KI82/22.
9. Më 4 tetor 2022, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi dokumentacionin e lartpërmendur.
10. Më 13 dhjetor 2022, bazuar në paragrafin 2 të nenit 42 (E drejta në dëgjim dhe heqja dorë) të Rregullores së punës, Gjykata vendosi për mbajtjen e seancës dëgjimore duke marrë parasysh që në rrethanat e rastit konkret konsideroi se është i nevojshëm qartësimi i disa çështjeve faktike lidhur me largimin e nga puna, kthimin në punë dhe lartësinë e kompensimit të parashtruesit të kërkesës si rrjedhojë e largimit të kundërligjshëm nga puna të këtij të fundit nga pala kundërshtarë Pro Credit Bank-Dega në Pejë.

11. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
12. Më 30 mars 2023, Gjykata u dërgoi ftesat për pjesëmarrje në seancën dëgjimore publike parashtruesit të kërkesës dhe Pro Credit Bank-Dega në Pejë.
13. Më 13 dhe 14 prill 2023, parashtruesi i kërkesës dhe Pro Credit Bank-Dega në Pejë konfirmuan pjesëmarrjen në seancën publike dëgjimore.
14. Më 25 prill 2023, u mbajt seanca dëgjimore publike. Parashtruesi i kërkesës dhe përfaqësuesi i tij z. Isa Salihi, avokat nga Prishtina si dhe përfaqësuesi i Pro Credit Bank, z. Kujtim Kërveshi nga Shoqëria e Avokatëve "Kërveshi & Partners" nga Prishtina, ishin të pranishëm në seancën dëgjimore publike.
15. Më 7 qershor 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
16. Në të njëjtën ditë, Gjykata vendosi, njëzëri/me shumicë që (i) kërkesa është e pranueshme; (ii) se ka pasur shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; (iii) shpall të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 103/2022] të 30 marsit 2022, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 504/19] të 13 tetorit 2021, Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë [C. nr. 1507/16] të 22 tetorit 2018; (v) çështja e anulimit si të kundërligjshëm të njoftimit për largim nga puna të parashtruesit të kërkesës dhe çështja e kthimit të të njëjtit në vendin e mëparshëm të punës janë çështje të gjykuara *res judicata*, të vërtetuara me Aktgjykimin [Ac. nr. 1955/13] të Gjykatës së Apelit të 27 janarit 2016.

Përmbledhje e fakteve

17. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës përmes të autorizuarit të tij më 26 janar 2011, në Gjykatën Komunale në Prishtinë kishte paraqitur padi kundër të paditurës Pro Credit Bank me seli në Prishtinë, të cilën e kishte precizuar me parashtrësën e datës 20 tetor 2012, me të cilën ka kërkuar që të anulohet si i kundërligjshëm njoftimi i kundër të paditurës Pro Credit Bank me seli në Prishtinë i datës 15 dhjetor 2010, për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në mënyrë të kundërligjshme, të detyrohet e paditura që parashtruesin e kërkesës ta kthej në vendin e mëparshëm të punës si Zyrtar Kreditor-Dega Pro Credit Bank në Pejë, si dhe të detyrohet e paditura që parashtruesit të kërkesës në emër të kompensimit të ardhurave personale të papaguara për periudhën nga data 01.09.2009 e deri më 31 gusht 2012, t'ia paguaj shumën prej 18.724,69 euro, në emër të kontributit të papaguar për sigurimin pensional dhe invalidor në llogari të Trustit Pensional shumën prej 2.070 euro, si dhe që nga dt. 01.09.2012 e derisa parashtruesi i kërkesës të kthehet në vendin e punës tek e paditura t'ia paguaj për çdo muaj 850 euro në emër të të ardhurave personale mujore, e këtë me kamatë prej 3.5% për çdo muaj, ndërsa në emër të shpenzimeve të procedurës shumën prej 779,72 euro, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përbarimit me dhunë.
18. Më 14 dhjetor 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë përmes Aktgjykimit [C. nr. 2569/11] vendosi: **(i) MIRATOHET** e bazuar kërkesëpadija e parashtruesit të kërkesës dhe **ANULOHET** si i kundërligjshëm njoftimi i të paditurës "Pro Credit Bank" në Prishtinë i datës 15.12.2010 për përmbylljen e kontratës së punës; **(ii) DETYROHET** e paditura "Pro Credit Bank" në Prishtinë që parashtruesin e kërkesës ta kthej në vendin e mëparshëm të punës Zyrtar Kreditor Dega "Pro Credit Bank" në Pejë; **(iii)**

DETYROHET e paditura “Pro Credit Bank” në Prishtinë që parashtruesit të kërkesës në emër të të ardhurave personale mujore të parealizuara për periudhën kohore dt. 01.09.2009 deri më 31.08.2012 duke i llogaritur edhe kamatën sipas arritjeve mujore për pagesë, t’ia paguajë shumën prej 18.724, 69 euro, në emër të kontributit të papaguar për sigurimin pensional dhe invalidor në llogari të Trustit Pensional shumën prej 2.070 euro, si dhe që nga dt. 01.09.2012 e derisa parashtruesi i kërkesës të kthehet në vendin e punës tek e paditura t’ia paguaj për çdo muaj 850 euro në emër të të ardhurave personale mujore, e këtë me kamatë prej 3.5% për çdo muaj; **(iv) DETYROHET** e paditura që kthimin e parashtruesit të kërkesës në vendin e punës sipas pikës II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pagesat e shumave sipas pikës III të dispozitivit si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës në shumë prej 779,72 euro, t’i bëj në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, me kërcënim të përmbarimit forcërisht.

19. Gjykata Komunale në Prishtinë arsyetoi: **(i)** është vërtetuar fakti se parashtruesit të kërkesës në mënyrë të kundërligjshme i është mohuar e drejta në ngritjen e pagës për periudhën prej dt. 01.09.2009 e deri më dt. 15.01.2011 nga 600 euro në 850 euro; **(ii)** parashtruesit të kërkesës në mënyrë të kundërligjshme i është ndërprerë marrëdhënia e punës për periudhën kontestuese prej dt. 15.01.2011 deri më dt. 31.08.2012 dhe i është pamundësuar që realizoj të ardhura personale; **(iii)** gjykata e bazoi ekspertizën financiare të cilën e kreu eksperti gjyqësor-financiar A.B., me dt. 14.08.2012, i cili përlllogaritjen e të ardhurave personale e ka kryer duke marrë për bazë pagat e kolegëve të tij analistë të kredive tek e paditura, të cilët në të njëjtën kohë dhe pozitë kanë qenë të punësuar tek e paditura sikurse parashtruesi i kërkesës; **(iv)** gjykata vlerëson se në rastin konkret parashtruesit të kërkesës kontrata e punës i është ndërprerë edhe në kundërshtim me nenin 72 të ligjit të punës sepse e paditura kontratën e punës e ka ndërprerë me njoftim dhe jo me vendim siç parashihet me këtë dispozitë ligjore; **(v)** me dispozitën e nenit 80 të ligjit të punës nëse largimi nga puna është i paligjshëm gjykata mund ta rikthej të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë kohës së largimit të paligjshëm nga puna; **(vi)** në rastin konkret e paditura nuk ka zbatuar nenin 70.3 të ligjit të punës sepse nuk ka prova që parashtruesi i kërkesës është ftuar në takim me punëdhënësin për t’ia shpjeguar shkaqet për të cilat e paditura mendon që ta ndërpresë kontratën e punës, dhe se parashtruesi i kërkesës nuk është njoftuar për mundësinë që në takim të tillë të shoqërohet nga ndonjë përfaqësues të zgjedhur nga ai; **(vii)** vetëm citimi i nocionit performansë e pakënaqshme në punë pa u specifikuar kriteret, shkaqet dhe rrethanat në të cilat bazohet ajo nuk është e mjaftueshme për ta treguar nivelin e performansës së të punësuarit.
20. Pala e paditur Pro Credit Bank paraqiti ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet e bazuar ndërsa aktgjykimi i goditur të priset dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, ose aktgjykimi i goditur të ndryshohet ashtu që kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës të refuzohet në tërësi e pabazuar.
21. Më 27 qershor 2016, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 1955/13] vendosi: **(i) REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të të paditurës Pro Credit Bank me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.2596/11, i datës 14.12.2012, në pikën (I) (një) dhe II (dy) të dispozitivit **VËRTETOHET**; **(ii) APROVOHET** pjesërisht e bazuar ankesa e të autorizuarit të të paditurës Pro Credit Bank me seli në Prishtinë, **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 2569/11 i datës 14.12.2012, në pikën III dhe IV të

dispozitivit (*përveç afatit për përmbushjen e detyrimit në pjesën e vërtetuar*) dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje në këtë pjesë.

22. Gjykata e Apelit arsyetoi: **(i)** Gjykata e Apelit duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë në pjesën e dispozitivit e cila me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit është vërtetuar (pika I e aktgjykimit) është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se e drejta materiale është zbatuar drejtë; **(ii)** gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, duke i provuar të gjitha faktet vendimtare të çështjes duke krijuar kështu një figurë të qartë të gjendjes faktike; **(iii)** gjykata e shkallës së parë në këtë pikë është mjaftuar me vlerësimin e ekspertit financiar duke lejuar kështu që eksperti ta përcaktojë vëllimin e të drejtës; **(iv)** eksperti nuk mund të përcaktojë nëse palës i takon një e drejtë sepse eksperti mundet vetëm që në bazë të kërkesës së gjykatës ta kryej vlerësimin e lartësisë së kërkesës; **(v)** gjykata e shkallës së parë në vendosje të sërishme duhet të ketë vëmendje sepse kontrata e punës është bazë për përcaktimin e të drejtave dhe detyrave të punës e në lidhje me këtë edhe lartësinë e pagës; **(vi)** në këtë kontekst është me rëndësi të vlerësohet nëse punonjësi kryen detyra tjera të punës që nuk janë të përcaktuara me kontratë e që për të njëjtën punë punonjësit tjerë paguhen më shumë apo nëse i njëjti është diskriminuar nga punonjësit tjerë pavarësisht se kryen detyrat e punës identike me të tjerët; **(vii)** për pjesën e kthyer në rigjykim udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në ri-procedurë të vërtetojë se a i takon parashtruesit të kërkesës pagë më e lartë se paga në kontratë nga cila periudhë fillon të rrjedhë dhe atë nga ndërprerja e marrëdhënies së punës 15.12.2010, apo para ndërprerjes së kontratës përkatësisht nga data 01.09.2009 e në vijim; **(viii)** pastaj varësisht nga vlerësimi i gjykatës për vëllimin e kërkesës të vendoset edhe për kërkesën që i referohet kursimeve në trustin pensional; **(ix)** për çështjen e kamatës duhet të vendoset në ri-procedurë pasi që kërkesa për kamatë është kërkesë aksesore dhe e ndan fatin e kërkesës kryesore.
23. Më 15 mars 2018, parashtruesi i kërkesës e precizoi kërkesëpadinë duke kërkuar që pala e paditur të detyrohet: Të detyrohet e paditura t'i paguajë paditësit kompensim për shkak të largimit të kundërligjshëm nga puna, në bazë të nenit 80, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2, të Ligjit të Punës, si në vijim: a) Në emër të të ardhurave personale të përealizuara prej 01.09.2009 deri më 31.08.2012, shumën neto prej 18.724,69 euro b) Në emër të kontributit të papaguar në sigurimin pensional për periudhën prej 01.09.2009 deri më 31.08.2012, shumën prej 2070,00 euro; c) Në emër të taksave në AT për këtë periudhë prej 01.09.2009 deri më 31.08.2012, e cila duhet të paguhet në ATK, në shumën prej 1,339,75 euro.
24. Më tej, parashtruesi i kërkesës kërkoi që e paditura të detyrohet që paditësit **a)** në emër të pagave të papaguara dhe diferencës së pagave për të ardhurat personale të përealizuara për periudhën nga data 01.09.2012 deri 30.06.2017, së bashku me kamatën ligjore t'ia paguaj parashtruesit të kërkesës shumën prej 54, 340.00 euro; **b)** në emër të diferencës të të ardhurave personale të papaguara (1,326.93 euro-600 euro) nga data 01.07.2017 deri 22.10.2018 t'ia paguaj veç e veç nga 615 euro; **c)** në emër të mosshfrytëzimit të pushimit vjetor për vitin 2011-2016 së bashku me kamatë ligjore për këtë periudhë parashtruesit të kërkesës t'ia paguajë shumën prej 4,412.52 euro; **d)** në emër të kontributit pensional, për periudhën prej 01.09.2012 deri 30.06.2017 i cili duhet të transferohet në Trustin e Kursimeve Pensionale të parashtruesit të kërkesës, së bashku me kamatën ligjore për këtë periudhë, shumën prej 6,028.00 euro; **e)** në emër të tatimit në këto paga së bashku me kamatën ligjore për këtë periudhë 01.09.2012 deri 30.06.2017 e cila shumë duhet të transferohet nga llogaria e ATK-së në shumë prej 4,439.00 euro; **f)** në emër të tatimit në AP të përealizuara për periudhën 01.07.2017 e tutje deri në pagesën definitive në llogarinë e ATK-së, të paguaj për çdo

muaj veç e veç nga 43.67 euro; **g)** në emër të kontributeve pensionale për periudhën 01.07.2017 e tutje deri në pagesën definitive të paguaj çdo muaj veç e veç shumën prej 69.33 euro; **h)** bazuar në nenin 144.2 të LPK-së, parashtruesit të kërkesës, në emër të të ardhurave personale mujore për të ardhmen t'ia paguajë për çdo muaj 1,326.93 euro, me kamatë 8 % duke u llogaritur nga data 01.11.2018 deri në pagesën definitive.

25. Parashtruesi i kërkesës kishte theksuar se Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit Ac. nr. 1955/13 të dt. 27.06.2016 ka vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2569/11 të dt. 14.12.2012 për kthim në vend të punës të parashtruesit të kërkesës ku ka qenë i caktuar "Zyrtar Kreditor-pranë Pro Credit Bank-Dega Pejë" dhe parashtruesi i kërkesës ka filluar punën nga dt. 01.10.2016, mirëpo, çështja është kthyer në ri procedurë lidhur me borxhin që e paditura Pro Credit Bank ka ndaj parashtruesit të kërkesës, në emër të të ardhurave personale të perealizuara dhe të drejtave tjera aksesore nga marrëdhënia e punës nga dt. 01.09.2009 e tutje.
26. Parashtruesi i kërkesës kishte theksuar se pas kthimit në punë nga dt. 01.10.2016 e deri në ditën e sotme, parashtruesi i kërkesës pranë të paditurës Pro Credit Bank i ka realizuar pagat jo të plota, më pak se 50% të tyre, për çka eksperti financiar A.B., në raportin e tij plotësues të dt. 12.03.2018, ka llogaritur këtë shumë të të hollave.
27. Më 22 tetor 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktgjykimit [C. nr. 1507/16] vendosi: **(i) APROVOHET** pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës, **DETYROHET** e paditura, që parashtruesit të kërkesës t'ia kompensojë në emër të të ardhurave personale për periudhën 01.09.2012 e deri më 30.09.2016, shumën prej 41.678.00 euro paga neto, përfshirë edhe kontributin pensional në shumë prej 2,319.00 euro, tatimi në burim në shumë prej 1.191.94 euro e që paraqet dyfishin e shumës prej 20,839.00 euro, të gjitha këto me kamatën vjetore ligjore siç paguajnë bankat për mjetet pa destinacion të caktuar, të afatizuar për 12 muaj duke filluar nga data 22.10.2018 e deri në pagesën e plotë, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 3,428.12 euro, e të gjitha kërkesat në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit ligjor;

(ii) REFUZOHET pjesa e kërkesëpadisë me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës ndaj të paditurës Pro CreditBank në tërësi si e bazuar dhe të anulohen si të kundërligjshme neni 4 i kontratës së punës, nr. 16/88, i datë 29.06.2016 e lidhur në mes të parashtruesit të kërkesës dhe të paditurës, me të cilën parashtruesi është kthyer në vendin e punës si analist kredie dhe neni 8 i kësaj kontrate me të cilin parashtruesit të kërkesës i është caktuar paga mujore në shumë prej 600.00 euro nga data 03.10.2016 e tutje;

Të detyrohet e paditura t'i paguajë paditësit kompensim për shkak të largimit të kundërligjshëm nga puna, në bazë të nenit 80, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2, të Ligjit të Punës, si në vijim:

- a)** në emër të të ardhurave personale të perealizuara prej 01.09.2009 deri më 31.08.2012, shumën neto prej 18.724,69 euro
b) Në emër të kontributit të papaguar në sigurimin pensional për periudhën prej 01.09.2009 deri më 31.08.2012, shumën prej 2070,00 euro;
c) Në emër të taksave në AT për këtë periudhë prej 01.09.2009 deri më 31.08.2012, e cila duhet të paguhet në ATK, në shumën prej 1,339,75 euro.

Të detyrohet e paditura si në pikën II nën a, b, c të këtij petitumi t'i paguajë si mjete të afatizuara për më tepër se një vit pa destinacion të caktuar, duke filluar nga 01.09.2012 e deri në pagesën e plotë:

Të detyrohet e paditura që paditësit:

- a) Në emër të pagave të papaguara dhe diferencës së pagave për të ardhurat personale të parealizuara për periudhën nga data 01.09.2012 deri 30.06.2017, së bashku me kamatën ligjore t'ia paguaj parashtruesit të kërkesës shumën prej 54, 340.00 euro;
 - b) në emër të diferencës të të ardhurave personale të papaguara (1,326.93 euro-600 euro) nga data 01.07.2017 deri 22.10.2018 t'ia paguaj veç e veç nga 615 euro;
 - c) në emër të mosshfrytëzimit të pushimit vjetor për vitin 2011-2016 së bashku me kamatë ligjore për këtë periudhë parashtruesit të kërkesës t'ia paguajë shumën prej 4,412.52 euro;
 - d) në emër të kontributit pensional, për periudhën prej 01.09.2012 deri 30.06.2017 i cili duhet të transferohet në Trustin e Kursimeve Pensionale të parashtruesit të kërkesës, së bashku me kamatën ligjore për këtë periudhë, shumën prej 6,028.00 euro;
 - e) në emër të tatimit në këto paga së bashku me kamatën ligjore për këtë periudhë 01.09.2012 deri 30.06.2017 e cila shumë duhet të transferohet nga llogaria e ATK-së në shumë prej 4,439.00 euro;
 - f) në emër të tatimit në AP të parealizuara për periudhën 01.07.2017 e tutje deri në pagesën definitive në llogarinë e ATK-së, të paguaj për çdo muaj veç e veç nga 43.67 euro;
 - g) në emër të kontributeve pensionale për periudhën 01.07.2017 e tutje deri në pagesën definitive të paguaj çdo muaj veç e veç shumën prej 69.33 euro;
- Që e paditura të detyrohet që borxhin si në pikën IV. nën a, c, d, e, f dhe g, të këtij petitumi, ta paguajë si mjete të afatizuara për më tepër se një vit pa destinacion të caktuar, duke filluar nga 01.07.2017 deri në pagesën përfundimtare dhe borxhin si në pikën IV. nën b, ta paguajë me interes 8%, për çdo muaj veç e veç, duke filluar nga 01.07.2017 e më tej, deri në pagesën përfundimtare;

Që e paditura të detyrohet që në bazë të nenit 144.2 të LPK-së, në emër të të ardhurave personale mujore për të ardhmen t'ia paguajë paditësit për çdo muaj 1,326.93 euro, me kamatë 8 % duke u llogaritur nga data 01.11.2018 deri në pagesën definitive si **kërkesë e pabazuar**.

28. Gjykata Themelore arsyetoi: **(i)** gjykata ekspertizën e plotësuar financiare sa i përket llogaritjes së pagave dhe kontributeve për paditësin për periudhën kontestuese e pranoi të bazuar dhe argumentuar mirë; **(ii)** kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës është e bazuar sa i përket pagesës së të ardhurave për periudhën kontestuese andaj edhe ka detyruar të paditurën që të kompensojë pagat për periudhën 01.09.2012 e deri më 30.09.2016, dhe se me rastin e llogaritjes është marrë për bazë paga e kontraktuar 600 euro bruto në muaj për parashtruesin e kërkesës si analist i kredive sipas kontratës së datës 27.03.2009 dhe ajo e fundit nr.16188 e datës 29.09.2016; **(iii)** me rastin e vendosjes së lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata ka marrë për bazë edhe të ardhurat që parashtruesi i kërkesës i ka realizuar paraprakisht në institucionet publike konkretisht në kompaninë regjionale të mbeturinave "Ambienti" sh.a., ku të ardhurat e realizuara nga kjo kompani për periudhën kontestuese janë reduktuar në të ardhurat në emër të pagave për parashtruesin e kërkesës; **(iv)** gjykata e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës pasi që baza juridike e kërkesëpadisë për këtë kategori të kërkesës është krijuar me anulimin e vendimit të të paditurës dhe me detyrimin e saj që parashtruesin e kërkesës ta kthej në punë, ndërsa për pjesën e refuzuar vendosi sinë dispozitiv të këtij aktgjykimi; **(v)** bazuar në nenin 32.5 të ligjit të punës ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor nuk mund të kompensohen me para, përjashtimisht kjo mund të bëhet kur skadon marrëdhënia e punës kurse në rastin konkret parashtruesit të kërkesës nuk i ka skaduar marrëdhënia e punës; **(vi)** bazuar në nenin 80.1.1 të ligjit të punës, gjykata vendosi që parashtruesit të kërkesës t'i kompensohet dyfishi i pagave pasi që është vërtetuar se parashtruesi i kërkesës në mënyrë të kundërligjshme i është ndërprerë marrëdhënia e punës; **(vii)** ndërsa për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat përkatëse të LMD-së.

29. Më 8 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktgjykimit [C. nr. 1507/16] të Gjykatës Themelore të 22 tetorit 2018 kryesisht kundër pjesës refuzuese të kërkesëpadisë përkatësisht pikën II të aktgjykimit në fjalë duke pretenduar: (i) shkelje të standardeve evropiane për të drejtat e njeriut për një proces të drejtë gjyqësor nga një gjykatë e paanshme dhe e pavarur; (ii) shkelje esenciale të dispozitave procedurale kontestimore; (iii) konstatim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike; dhe, (iv) aplikim të gabuar të dispozitave të së materiale.
30. Lidhur me shkeljet e dispozitave procedurale, parashtruesi i kërkesës pretendoi se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për faktet vendimtare çka e bën të pakuptimtë por edhe të papërmbarueshëm aktgjykimin e shkallës së parë. Parashtruesi i kërkesës kishte theksuar se janë kryer shkelje esenciale të dispozitave të neneve 144 dhe 146 të LPLK-së lidhur me nenin 186 të LMD-së i dhe dispozita tjera të ligjit të punës.
31. Lidhur me vlerësimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së parë, parashtruesi i kërkesës pretendoi se për periudhën 01.09.2009 deri më 31.08.2012 bazuar në raportin financiar të ekspertit A.B., rezultoi se pagat e porealizuara së bashku me kamatë ligjore arrijnë shumën prej 18,724.69 euro, kontributi pensional arrin lartësinë prej 2.070. euro, ndërsa paga neto mujore që e paditura duhet t'ia paguaj parashtruesit të kërkesës derisa të kthehet në vendin e punës është 850 euro. Sipas parashtruesit të kërkesës, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka konstatuar gjendjen faktike për periudhën e lartpërmendur lidhur me pikën të dispozitivit që refuzon kërkesëpadinë për pagesën e të ardhurave personale dhe të kërkesave tjera aksesore nga marrëdhënia e punës për këtë periudhë.
32. Lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale parashtruesi i kërkesës pretendoi se pika I e dispozitivit të aktgjykimit të kontestuar, gjykata e shkallës së parë gabimisht mbështetet në dispozitën e nenit 80 para. 1.1. të ligjit të punës për shkak se kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me kompensim të të ardhurave personale dhe kërkesave aksesore nga marrëdhënia e punës si dhe diferencës në kërkesat e papaguara siç janë specifikuar në kërkesëpadi. Sipas parashtruesit të kërkesës ai ishte kthyer në vendin e punës me vendim të përmbarueshëm gjyqësor, prandaj, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vendosur për kthim në punë të parashtruesit të kërkesës dhe është dashur që të mbështetet në dispozitën e nenit 80 para. 1.2. të ligjit të punës që parashikon: *“nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna.”* Parashtruesi i kërkesës po ashtu pohoi se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale sepse të hyrat që parashtruesi i kërkesës i ka realizuar në kompaninë rajonale “Ambienti” sh.a., në Pejë nuk janë të ardhura personale në kuptim të ligjit të punës por si anëtar i bordit të kompanisë në fjalë, për çka ai ka paguar tatimin në ATK sipas ligjit për tatimin e të hyrave të realizuara. Parashtruesi i kërkesës kishte theksuar se të drejtën për kompensim të dëmit për të ardhurat personale të papaguara dhe kërkesave tjera aksesore e bazon në dispozitat ligjore të së drejtës materiale përkatësisht në dispozitat e neneve 55, 58 dhe 50 të ligjit të punës dhe dispozitat e neneve 136,137 dhe 140 të LMD-së.
33. Pala e paditur kishte paraqitur përgjigje ndaj ankesës së parashtruesit të kërkesës duke pretenduar: (i) shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 dhe 182.2 të LPK-së; (ii) zbatimin të gabuar të së drejtës materiale; dhe, (iii) propozim, që të aprovohet ankesa e të paditurës ashtu që të ndryshohet pjesërisht aktgjykimi i kontestuar nën pikën I të dispozitivit në atë mënyrë që të aprovohet vetëm sa i përket shumës prej, 20.839.00 euro dhe jo dyfishi i kësaj shume siç është vendosur

me aktgjykimin e kontestuar. Lidhur me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, pala e paditur pretendoi se gjykata e shkallës së parë ka shkelur nenin 182.2 të LPK-së pasi që ka tejkalar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Pala e paditur kishte theksuar se parashtruesi i kërkesës periudhën 01.09.2012 deri 30.09.2016, ka kërkuar vetëm pagesën e pagave të papaguara por jo edhe dyfishin e tyre. Lidhur me zbatimin e të drejtës materiale, pala e paditur, kishte pretenduar se në rastin konkret është në kundërshtim me nenin 80.1 të ligjit të punës, përderisa, në vendimin paraprak të gjykatës, parashtruesi i kërkesës është kthyer në vendin e punës bazuar në dispozitën e nenit 80 paragrafi 1.2., atëherë edhe lartësia e kompensimit duhet të jetë në përputhje me dispozitën e nenit 80 paragrafi 1.2., të Ligjit të punës dhe jo në bazë të paragrafit 2 të nenit 80 të Ligjit të punës.

34. Më 13 tetor 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 504/19] vendosi si në vijim: **(i) REFUZHET** e pathemeltë ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të parashtruesit të kërkesës ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1507/16 i datës 22.10.2018 në pikën I të dispozitivit në pjesën që ka të bëjë me kamatën dhe shpenzimet e procedurës dhe pika II e dispozitivit të aktgjykimit **VËRTETOHET**; **(ii) APROVOHET** e themeltë ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës Pro Credit Bank, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë [C.nr.1507/16], i datës 22.10.2018 në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit në pjesën e kompensimit të të ardhurave personale, kontributit pensional si dhe tatimit në burim ashtu që tani gjykohet si vijon: **DETYROHET** e paditura Pro CreditBank, që parashtruesit të kërkesës t'ia kompensojë në emër të të ardhurave personale për periudhën prej 01.09.2012 e deri më 30.09.2016 shumën prej 20, 839.00 euro, ku prej tyre për kontributin pensional t'i paguajë shumën prej 2,139.00 euro ndërsa për tatim në burim t'i paguajë shumën prej 1, 191.94 euro.
35. Gjykata e Apelit arsyetoi: **(i)** se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm vetëm lidhur me pjesën e kompensimit të të ardhurave personale, kontributit pensional si dhe tatimit në burim; **(ii)** përkitazi me pretendimin për paanshmërinë e gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit vlerësoi se kur një palë e vë në dyshim paanshmërinë e gjykatës dhe konsideron se gjykata ka zhvilluar në proces jo të drejtë ligjor, duhet të jep arsye konkrete lidhur me këtë çështje; **(iii)** nuk ekzistojnë shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore sepse dispozitivi i aktgjykimit të goditur nuk është në kundërshtim me arsyetimin e të njëjtit; **(iv)** aktgjykimi i gjykatës komunale në asnjë pjesë nuk përcakton se kontrata lidhet sipas atij aktgjykimi, me atë aktgjykim vetëm është detyruar e paditura që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës, ndërsa për kushtet e kontratës gjykata nuk mund të vendos për arsye se kjo është çështje për të cilën palët merren vesh vetë; **(v)** e paditura nuk ka obligim që të paguaj më tepër se sa kompensimi i shumës së pagës sa ka qenë në kohën kur parashtruesi i kërkesës ishte larguar kundërligjshëm nga puna dhe se kjo gjen mbështetje në nenin 55 të ligjit të punës; **(vi)** shumën e aprovuar tejkalon kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe se me këtë rast janë kryer shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; **(vii)** largimi i parashtruesit të kërkesës nga puna ka qenë i kundërligjshëm dhe për atë arsye me vendim i njëjti është rikthyer në vendin e punës, prandaj, parashtruesit të kërkesës i takon vetëm kompensimi i të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë largimit të tij nga puna, por jo edhe dyfishi i tyre; **(viii)** Gjykata e Apelit theksoi se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar dispozitat e nenit 80.1.1 dhe 1.2. të ligjit të punës, sepse këto dispozita nuk mund të zbatohen në mënyrë kumulative por alternative dhe varësisht nga rrethanat e zbaton vetëm njërin prej paragrafëve të nenit 80 të ligjit të punës; **(ix)** sepse sipas Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë është dashur ose të urdhërojë kompensimin e dyfishtë të pagave që takon gjatë kohës së largimit nga puna, ose të urdhërojë kthimin e parashtruesit në punë dhe kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve të humbura gjatë kohës së largimit të paligjshëm nga

puna; (x) logjikisht dhe juridikisht parashtruesi i kërkesës është dëmtuar vetëm për ato paga që i njëjti do të kishte mundësi t'i realizonte sikur të mos i ndërpritej marrëdhënia e punës.

36. Parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje të standardeve ndërkombëtare, shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet në pjesën refuzuese, të aprovohet kërkesëpapia e parashtruesit të kërkesës ose aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë të prishen dhe çështja të kthehet në rigjykim.
37. Në revizion drejtuar Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës kishte kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C. nr. 1507/16 i 22 tetorit 2018 si dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 504/2019 të 13 tetorit 2021. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se Gjykata Themelore në ri-procedurë lidhur me kërkesën e parashtruesit të kërkesës për kompensim të dëmit për shkak të mos pagesës së të ardhurave personale dhe kërkesave tjera aksesore nga marrëdhënia e punës nuk u është përmbajtur vërejtjeve dhe sugjerimeve të Gjykatës së Apelit përmes Aktgjykimit Ac.nr.1955/13 të 27 qershorit 2016. Parashtruesi i kërkesës kishte theksuar se ai ishte kthyer në vendin e punës tek e paditura Pro Credit Bank, në procedurë të përbarimit të dhunshëm, përmes Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë E. nr. 541 të dt. 06.02.2017 i cili ishte bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Prishtinë, C. nr. 2569/11 të dt. 14.12.2012 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac. nr. 1955/13 të dt. 27.06.2016. Parashtruesi i kërkesës shtoi se Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit Ac. nr. 1955/13 të 27 qershorit 2016 ka caktuar ekspertin financiar A.B., i cili në raportin e dt. 14.07.2017 dhe atë plotësues të 12.03.2018, në mënyrën më të drejtë ka llogaritur të ardhurat personale të përealizuara të parashtruesit të kërkesës dhe të drejtat tjera aksesore nga marrëdhënia e punës, pas kthimit të çështjes në ri procedurë nga Gjykata e Apelit, duke filluar nga dt.01.09.2012 deri më dt. 30.06.2017. Ndërsa për periudhën e mëhershme, i njëjti ekspert A.B., në raportin e parë të dt. 14.08.2012 ka llogaritur të ardhurat personale dhe të drejtat aksesore nga marrëdhënia e punës për periudhën dt. 01.09.2009 deri më dt. 31.08.2012. Parashtruesi i kërkesës kishte theksuar se bazuar në raportin financiar të ekspertit A.B., të dt. 14.08.2012 për periudhën dt. 01.09.2009 deri më dt. 31.08.2012 arrin shumën prej 18,132,00 euro që së bashku me kamatën ligjore arrijnë shumën prej 18,724.69 euro, ndërsa kontributi pensional arrin lartësinë prej 2,070 euro, kurse paga neto mujore që e paditura duhet t'ia paguajë parashtruesit të kërkesës derisa i njëjti të kthehet në vendin e tij të punës, është 850 euro në muaj, mirëpo, Gjykata Themelore me Aktgjykimin C. nr. 1507/16 i 22 tetorit 2018, në pikën II, pasuesi i dytë (p.nr.) në tërësi e refuzon kërkesën e parashtruesit të kërkesës që t'i paguhen të ardhurat personale të përealizuara dhe kërkesat aksesore nga marrëdhënia e punës për periudhën dt. 01.09.2009 deri më dt. 31.08.2012 dhe lidhur me të njëjtën periudhë, Gjykata Themelore nuk e arsyeton me asnjë fjali të vetme.
38. Parashtruesi i kërkesës, më tej, kishte theksuar se sipas vërejtjeve të tij si palë paditëse, eksperti financiar kishte nxjerrë një raport plotësues më dt.14.07.2017 dhe më 12.03.2018 lidhur me të ardhurat personale e përealizuara dhe kërkesat aksesore nga marrëdhënia e punës duke llogaritur: (i) dy periudhat nga dt. 01.09.2009 deri më dt. 31.08.2012 dhe periudhën nga dt. 01.09.2012 deri më dt. 30.06.2017; (ii) pastaj ndryshimin e të ardhurave personale të përealizuara dhe kërkesat aksesore nga marrëdhënia e punës nga dt. 01.07.2017 deri më dt. 22.10.2018 kur ka përfunduar shqyrtimi kryesor në ri procedurë; si, dhe; (iii) ndryshimin e të ardhurave personale të përealizuara dhe kërkesat aksesore nga marrëdhënia e punës për të ardhmen, pas dt.22.10.2018, deri në pagesën definitive, në kuptim të dispozitës së nenit 144.2 të LPK-së lidhur me dispozitën e nenit 186 të LMD-së.

39. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës kishte theksuar se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit nuk kanë konstatuar drejtë dhe plotësisht gjendjen faktike sepse kanë “potencuar” raportet financiare të dt.14.07.2017 dhe më 12.03.2018 kurse nuk kanë “potencuar fare” raportin financiar të dt. 14.08.2012. Parashtruesi i kërkesës po ashtu kishte theksuar se me parashtesën e dt. 15.03.2018 dhe në parashtrësën në formë të shkruar-në fjalën përfundimtare të dt. 22.10.2018, ka precizuar petitumin e kërkesëpadsisë për të gjitha bazat ligjore për realizim të të ardhurave personale e porealizuara dhe kërkesat aksesore nga marrëdhënia e punës duke llogaritur periudhat nga dt.01.09.2009 deri më dt. 31.08.2012, periudhën nga dt. 01.09.2012 deri më dt. 30.06.2017, periudhën nga dt. 01.07.2017 deri më dt. 22.10.2018 kur ka përfunduar shqyrtimi kryesor në ri procedurë dhe periudhës pas dt. 22.10.2018 deri në pagesën definitive.
40. Më 30 mars 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 103/2022] refuzohet i pathemeltë revizioni i parashtruesit të kërkesës paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 504/2019] të 13.10.2021.
41. Gjykata Supreme, ndër të tjera, arsyetoi: **(i)** Gjykata Supreme vlerëson se është i pranueshëm qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së dytë kur ka vendosur ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë duke e aprovuar shumën prej 20,839.00 euro dhe duke e refuzuar pjesën tjetër, dyfishin e kësaj shume; **(ii)** lidhur me pretendimin për diskriminim në kuptim të nenit 5 të ligjit të punës, Gjykata Supreme konsideron se në rastin konkret nuk është konsumuar i përshkruar në nenin 3 të ligjit për mbrojtje nga diskriminimi sepse nuk ka pasur dallim, përjashtim apo kufizim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë kundër parashtruesit të kërkesës; **(iii)** Gjykata Supreme më tej shtoi se diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuar në nenin 1 të ligjit për mbrojtje nga diskriminimi që kanë të bëjnë me veçoritë e pretenduesit të diskriminimit, kurse në rastin konkret me aktgjykimet e kontestuara të gjykatave të instancës më të ulët është shpallur i paligjshëm vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe është obliguar e paditura që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në punë; **(iv)** Gjykata Supreme vlerëson se është zbatuar drejtë dispozita e nenit 55 paragrafi 2 të ligjit të punës sepse parashtruesi i kërkesës është larguar kundërligjshëm nga puna dhe për këtë arsye me vendim është rikthyer në vendin e punës, mirëpo, parashtruesit të kërkesës i takon vetëm kompensimi i të gjitha pagave dhe përfitimeve të tjera të humbura gjatë largimit të tij nga puna, por jo edhe dyfishi i tyre; **(v)** sepse gjatë asaj kohe ai nuk ka qenë në punë e as që ka kryer punë për të paditurën, andaj edhe pretendimet e revizionit lidhur me këtë u refuzuan të pabazuara.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

42. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.
43. Parashtruesi i kërkesës pohon se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së kërkojnë, ndër të tjera, që gjykata dhe trupi gjykues duhet të jetë themeluar me ligj, që trupi gjykues të jetë i pavarur dhe i paanshëm, që palët të kenë mundësi të barabarta për të prezantuar rastin e tyre apo parimi i barazisë së armëve, që qasja në gjykatë të jetë efektive e jo vetëm formale, që e gjithë procedura gjyqësore të jetë zhvilluar dhe administruar në një mënyrë të drejtë, që një aktgjykim apo aktvendim përmes të cilit vendoset mbi të drejtat dhe detyrimet të përmbajë arsyetim të mjaftueshëm rreth pretendimeve të palëve.

44. Parashtruesi i kërkesës pretendon rasti i tij është zhvilluar për më shumë se 10 vite në gjykatat e rregullta çka nënkupton se atij i është cenuar e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm sidomos duke pasur parasysh natyrën e kontestit e që është ndërprerja e marrëdhënies së punës.
45. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Gjykata e Apelit, duke ndryshuar dispozitivin e Aktgjykimit të Shkallës së parë, ka vepruar në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore duke e zvogëluar vlerën e kompensimit të pagave të papaguar për rreth 50%, Gjykata e shkallës së dytë fare nuk është marrë me shkeljet procedurale dhe materiale të cilat i ka bërë shkalla e parë në dëm të paditësit këtu parashtruesit të kërkesës, por vetëm me pretendimet ankimore të palës së paditur.”*
46. Parashtruesi i kërkesës pretendon se rasti i tij si proces gjyqësor në tërësi nuk është administruar drejtë çka përfshin edhe mënyrën se si janë nxjerrë, administruar dhe si është vendosur lidhur me provat e palëve ndërgjyqëse.
47. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon: *“Parashtruesi i Kërkesës përmes revizionit kishte kërkuar që Gjykata Supreme të konstatoj se Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë fare nuk ka shqyrtuar dispozitat ligjore nga nenit 53 dhe 71 të Ligjit të punës janë dy fakte që bazohen në prova dhe në ligj, e para paditësi nuk është njoftuar me kohë për largim nga puna konform nenit 71.”*
48. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se në rastin e tij është shkelur parimi i qasjes në gjykatë siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së sepse *“Duke mos administruar provat në mënyrë të drejtë Gjykata Supreme me rastin e vendosjes sipas Revizionit Rev. Nr. 103/2022 në tërësi vetëm ka përshkruar në stilin Copy Paste aktgjykimin e gjykatës së Apelit dhe në asnjë paragraf nuk e ka shqyrtuar pretendimet e Parashtruesit të Kërkesës.”*
49. Parashtruesi i kërkesës thekson se *“Më datën 15.09.2010, punëmarrësi në mënyrë të njëanshme i ka ndërprerë marrëdhënien e punës-shkëputur kontratën e punës, duke e njoftuar punëmarrësin që të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënja e punës, e elaboruar në pjesën hyrëse-historiati procedural. Parashtruesi i Kërkesës konsideron që Punëdhënësi ndërprerjen e kontratës e ka bërë në kundërshtim të plotë me procedurat ligjore, pra duke i cenuar rëndë të drejtat e Parashtruesit të Kërkesës, meqë sipas ligjit të Punës dhe marrëveshjeve të tjera kolektive të cilat janë të aplikuar në Republikën e Kosovës, procedurat për ndërprerjen e kontratës së punës duhet të aplikohen në perpikëmbëri, konsiderojmë që në rastin konkret punëdhënësi nuk e ka aplikuar asnjë nga dispozitat ligjore e ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Ky fakt është vërtetuar edhe nga Gjykata Themelore në Prishtinë në bazë të Aktgjykimit të dt.14.12.2012 me numër C. nr. 2569/11.”*
50. Më tej, parashtruesi i kërkesës *“...konsideron që Gjykata e shkallës së parë, e dytë dhe Gjykata Supreme e Kosovës, nuk e kanë vlerësuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike - pozicionin e tij, meqë të njëjtit i është ndërprerë kontrata e punës në mënyrë të kundërligjshme me dt. 15.09.2010, ndërsa me dt. 03.10.2016, është rikthyer në vendin e punës, në kuptim të këtij veprimi nga ana e punëdhënësit-Pro Credit Bankë, e njëjta ishte dashur që të detyrohet nga ana e Gjykatës që paditësit ti kompenzoj pagat mujore që nga dt. 15.09.2010 deri më dt. 03.10.2016, me kamat ligjore, meqë konsiderojmë që me rastin e rikthimit të të punësuarit në vendin e tij të punës është vërtetuar fakti që i njëjti është larguar nga vendi i punës në kundërshtim me dispozitat ligjore, fakt i pakontestueshëm, meqë me rikthimin e të paditësit në vendin e punës janë pjekur kushtet ligjore që paditësit ti kompenzohen të gjitha pagat në tërësi për periudhën në të cilën është përballur me procese gjyqësore për shkak të largimit të kundërligjshëm nga puna nga ana e punëdhënësit - të paditurës: Pro Credit Bankë.*

Paditësi konsideron se Gjykatat kompetente kanë bërë shkelje flagrante të të drejtave të tija të cilat garantohen me Kushtetutë.

51. Përkitazi me kompensimin për pagat e papaguara parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Pro Credit Bank, me veprimet e saja, i ka shkaktuar dëme të konsiderueshme me veprimet e saja të kundërligjshme, ndërsa në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës nuk është kompensuar aq sa do të kishte fituar po të kishte qenë i punësuar, meqë i njëjti për rreth 72 muaj nuk ka marrë fare pagë e në këtë kuptim bie që Gjykata i ka aprovuar vetëm gjysmës së pagës pra nga rreth 277 euro në muaj, e që është dashur që të kompensohet paga e cila ka qenë në kontratë si dhe rritjet të cilat janë bërë për punëmarrësit tjerë në pozicion të njëjtë me kualifikim të njëjtë.”*
52. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të konstatojë si në vijim: (i) që kërkesa të shpallet e pranueshme; (ii) se ka pasur shkelje të neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së; (iii) shpallet i pavlefshëm Aktgjykimi Rev. nr. 103/2022 i Gjykatës Supreme i 30 marsit 2022; (iv) të përcaktojë dhe vendos çfarëdo mase tjetër juridike që Gjykata Kushtetuese e vlerëson të bazuar në Kushtetutë dhe Ligj dhe që është e arsyeshme për rastin konkret.

Sqarimet e dhëna nga parashtruesi i kërkesës dhe përfaqësuesi i Pro Credit Bank në seancën dëgjimore publike

53. Në seancën dëgjimore publike të 25 prillit 2023, parashtruesi i kërkesës sqaroi: (i) nga data 15.12.2010 e deri më 31 gusht 2012 përkatësisht për tetëmbëdhjetë (18) muaj nuk i janë kompensuar pagat e papaguara dhe të drejtat aksesore nga marrëdhënia e punës për shkak të largimit të kundërligjshëm nga puna; (ii) ndërsa për periudhën 2012-2016 parashtruesit të kërkesës i janë zbritur 7000 euro nga kompensimi i pagave dhe të drejtave aksesore nga marrëdhënia e punës për shkak të angazhimit të këtij të fundit si anëtar bordi në kompaninë regjionale “Ambienti”; (iii) parashtruesi i kërkesës theksoi se nuk bëhet fjalë për konflikt interesi kur në vitin 2016 ishte kthyer në punë në Pro Credit Bank ndërsa kishte vazhduar të ishte anëtar bordi në kompaninë regjionale “Ambienti”; (iv) parashtruesi i kërkesës theksoi se lartësia e pagës që Pro Credit Bank duhet t’ia kompensojë atij është 850 euro sepse ka marrë vlerësim të mirë gjatë periudhës së punës; (v) parashtruesi i kërkesës theksoi se lartësia e pagës prej 600 euro ka qenë vetëm për periudhën provuese, por që edhe sikur paga e tij të llogaritej 600 euro, prapëseprapë ai është kompensuar vetëm me gjysmën e shumës që i takon; (vi) sipas parashtruesit të kërkesës është shumë e thjeshtë të kalkulohet shume prej 600 euro në raport me 72 muaj sa ai ka qenë i papunë dhe i pa kompensuar për largim të kundërligjshëm nga puna; (vii) parashtruesi i kërkesës theksoi se gjykata themelore ia ka njohur të drejtën në bazë të dispozitës ligjore nga neni 80 paragrafi 1 dhe pika 1 dhe pika 2 të Ligjit të Punës lidhur me dyfishin e të ardhurave personale, mirëpo, kjo e drejtë nuk është njohur me aktgjykimet e mëvonshme të gjykatave të rregullta; dhe (viii) se shkëputja e kontratës ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe Pro Credit Bank në vitin 2021 ka ndodhur në mënyrë të njëanshme për shkak se kjo e fundit ka ushtruar “presion psikologjik” ndaj parashtruesit të kërkesës.
54. Përfaqësuesi i Pro Credit Bank sqaroi: (i) bazuar në nenin 80 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës, gjykatat në mënyrë alternative vendosin ose kthimin në punë dhe pagesën e pagave të papaguara ose vetëm dyfishin e pagesës së pagave të papaguara; (ii) gjatë vlerësimit të lartësisë së kompensimit të parashtruesit të kërkesës, gjykatat e rregullta kanë krahasuar pagën e parashtruesit të kërkesës me pagën e tre punonjësve tjerë të Pro Credit Bank, në vend se të marrin për bazë vetëm pagën pagën e parashtruesit të kërkesës; (iii) krahasimi i pagës së parashtruesit të kërkesës me pagat e punonjësve tjerë bie ndesh me mbrojtjen e të dhënave personale të

këtyre të fundit; (iv) parashtruesit të kërkesës i është “deduktuar” shuma nga paga bazë prej 600 euro për kohën sa ka qenë i angazhuar në kompaninë regjionale “Ambienti”; (v) në këtë kontekst, pranimi i pagës nga Pro Credit Bank dhe nga kompania regjionale “Ambienti” në të njëjtën kohë, nuk është i lejuar me ligj dhe mund t’i nxjerrë “probleme” parashtruesit të kërkesës me ATK-në dhe jo vetëm me punëdhënësin e tij Pro Credit Bank; (vi) parashtruesit të kërkesës e drejta në pagë nuk i është cenuar asnjëherë sepse edhe kur është kthyer në punë pagat ka vazhduar t’i realizojë, kontestuese ka qenë lartësia e pagës çka edhe është vendosur nga gjykatat e rregullta duke u mbështetur në ekspertizën e ekspertit financiar; (vii) nuk kemi të bëjmë me shkelje të asnjë dispozite të Ligjit të Punës për çështjen e “deduktimit” të pagave dhe llogaritjen e lartësisë, për shkak se llogaritja e lartësisë është bërë në përputhje me pagën që parashtruesi i kërkesës do ta kishte realizuar; (viii) gjykatat kanë vlerësuar nëse parashtruesit të kërkesës i takon kompensimi i pagave apo dyfishi i tyre bazuar në nenin 80 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës; dhe se; (ix) gjykatat e rregullta drejtë kanë interpretuar dispozitën relevante të ligjit të punës kur parashtruesit të kërkesës nuk ia kanë akorduar dyfishin e pagës.

Dispozita relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”*

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”

Neni 53

[Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]

“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze

penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.”
[...]

Neni 13
(E drejta për zgjidhje efektive)

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

LIGJI NR. 03/L-212 I PUNËS

Neni 5
Ndalimi i të gjitha llojeve të diskriminimit

- 1. Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi.*
- 2. Ndalohej diskriminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i personave me aftësi të kufizuara gjatë punësimit, avancimit në punë dhe avancimit profesional, nëse për atë vend pune është i aftë ta kryejë punën në mënyrë adekuate.*
- 3. Nuk konsiderohet diskriminim, çdo dallim përjashtim ose dhënie e përparësisë, përkitazi me ndonjë vend të caktuar pune, në bazë të kriterëve të caktuara që kërkohen për atë vend pune.*
- 4. Punëdhënësi është i obliguar që në rastin e punësimit të punëtorëve, për të njëjtin vend pune të përcaktojë kriterë dhe mundësi të barabarta si për femra ashtu edhe për meshkuj.*
- 5. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/3 Kundër Diskriminimit, do të zbatohen drejtpërsëdrejti kur është në pyetje marrëdhënia e punës e lidhur në mes të të punësuarit dhe punëdhënësit.*

Neni 53
Ndalimi i shkëputjes së kontratës

Gjatë kohës së shtatzënisë, pushimit të lehonisë dhe mungesës në punë për shkak të përkuqdesjes së veçantë ndaj fëmijës, punëdhënësi nuk mund t'ia shkëpusë kontratën të punësuarit dhe t'ia ndërrojë vendin e punës, përveç në rastet e shkëputjes së kontratës sipas nenit 76 të këtij ligji.

Neni 55
Paga, kompensimi i pagës dhe të ardhurat e tjera

1. I punësuarit ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.
2. Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuarit i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës.
3. Punëdhënësi duhet t'i paguajë femrave dhe meshkujve kompensimin e njëjtë për punën e vlerës së njëjtë, kompensim i cili mbulon pagën bazë dhe shtesat e tjera.
4. Punëdhënësi duhet të nxjerrë një deklaratë për çdo pagesë dhe çdo shtesë tjetër të paguar të të punësuarve. Pagat mund të paguhen përmes transferit bankar ose me para të gatshme me ç' rast punëdhënësi duhet të mbajë regjistrin për pagesat e bëra.
5. Pagat në Kosovë paguhen sipas valutës zyrtare në Euro (€).
6. Paga, paguhet në afatet e përcaktuara me Kontratë Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ose Kontratën e Punës, më së paku një (1) herë në muaj.

Neni 71

Koha e njoftimit për ndërprerjen e kontratës së punës

1. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës në kohë të përcaktuar në bazë të nenit 70, të këtij ligji në këto intervale kohore të njoftimit:
 - 1.1. prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vite punësim, tridhjetë (30) ditë kalendarike;
 - 1.2. prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite punësimi, dyzetepesë (45) ditë kalendarike;
 - 1.3. mbi dhjetë (10) vite punësim, gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike.
2. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftim prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë punësuarin së paku tridhjetë (30) ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do t'i japë të drejtën të punësuarit për zgjatjen e tridhjetë (30) ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë.

Neni 72

Procedura para ndërprerjes së Kontratës

1. Vendimi për të ndërprerë kontratën e punës duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përfshijë arsyetimin për ndërprerje.
2. Vendimi nga paragrafi 1. i këtij neni është përfundimtar ditën kur i dorëzohet të punësuarit.
3. Punëdhënësi është i obliguar të bëjë pagesën e pagës dhe të ardhurave të tjera, deri në ditën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

4. Punëdhënësi mund t'i ndalojë qasjen punonjësit në objektin e ndërmarrjes gjatë periudhës së njoftimit, përkatësisht para ndërprerjes së kontratës së punës.

Neni 80

Vendosja gjyqësore lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës

1. Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve:

1.1. t'i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shumën të tillë që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit; ose

1.2. nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjukata mund ta rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna.

2. Punëdhënësi është i obliguar që në afatin e caktuar të zbatoj vendimin e gjykatës kompetente.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

55. Gjukata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuar me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.

56. Gjukata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

*“1. Gjukata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

57. Gjukata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjukata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashikojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjukata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

“2. Individu mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

58. Në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kanë specifikuar se kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.nr.103/2022] të Gjykatës Supreme të 30 marsit 2022, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë qartësuar të drejtat dhe liritë që ata pretendojnë se janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
59. Gjykata gjithashtu konsideron se kërkesa nuk mund të konsiderohet qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç parashihet me paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, dhe për pasojë, kërkesa shpallet e pranueshme për shqyrtim në merita. (shih, gjithashtu rastin e GJEDNJ-së, *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, nr. 20134/05, Aktgjykim i 9 korrikut 2012, paragrafi 144, si dhe shih rastet e Gjykatës [KI75/21](#), parashtrues “*Abrazen LLC*”, “*EnergyDevelopmentGroup Kosova LLC*”, “*Alsi&Co. Kosovë LLC*” dhe “*BuildingConstruction LLC*”, Aktgjykim i 19 janarit 2022, paragrafi 64; [KI27/20](#), parashtrues, *Lëvizja VETËVENDOSJE!*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, paragrafi 43).

Meritat e kërkesës

60. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.
61. Gjykata thekson se thelbi i rastit ndërlidhet me largimin e parashtruesit të kërkesës nga vendi i punës Zyrtar Kreditör nga pala e paditur Pro Credit Bank. Parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar që të anulohet si i kundërligjshëm njoftimi/vendimi i të paditurës Pro CreditBank dhe që e njëjta të detyrohet që parashtruesin e kërkesës ta kthej në vendin e mëparshëm të punës duke ia kompensuar të ardhurat personale të papaguara së bashku me kërkesat tjera aksesore që i takojnë me ligj. Gjykata Komunale në Prishtinë miratoi të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe anuloi të kundërligjshëm njoftimin e të paditurës Pro Credit Bank për përmbylljen e kontratës së punës dhe urdhëroi kthimin e parashtruesit të kërkesës në vendin e mëparshëm të punës duke ia kompensuar të ardhurat personale mujore të papaguara dhe kërkesat tjera aksesore që i takojnë me ligj. Pas ankesës së palës së paditur Pro Credit Bank, Gjykata e Apelit pjesërisht e miratoi ankesës së palës së paditur Pro Credit Bank dhe urdhëroi që çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata

Themelore në rigjykim miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për kompensimin e një pjese të të ardhurave personale të papaguara së bashku me kërkesat aksesore ndërsa e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për pjesën tjetër të të ardhurave personale të papaguara së bashku me kërkesat aksesore. Pas ankesave të parashtruesit të kërkesës dhe palës së paditur Pro Credit Bank, Gjykata e Apelit e refuzoi të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës në pjesën që ka të bëjë me kamatën dhe shpenzimet e procedurës dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në pjesën e kompensimit të të ardhurave personale dhe kërkesave tjera aksesore nga marrëdhënia e punës. Ndërkohë, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje të standardeve ndërkombëtare, shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë të prishen dhe çështja të kthehet në rigjykim. Gjykata Supreme me Aktgjykim e refuzoi të pathemeltë revizionin i parashtruesit të kërkesës paraqitur kundër aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore.

62. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, para gjykatave të rregullta, ka ngritur pretendime të detajuara lidhur me: (i) kompensimin e duhur të të ardhurave personale dhe kërkesave tjera aksesore për shkak të largimit të kundërligjshëm; (ii) largimin e kundërligjshëm nga puna dhe të drejtën e kthimit në vendin e punës; (iii) pretendim për cenim të parimit të barazisë së armëve dhe mos zgjidhjes së çështjes së tij brenda një afati të arsyeshëm.
63. Duke u nisur nga natyra dhe problematikat që i ngre ky rast, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës duhet të vlerësohen në kuadër të së drejtës për një vendim të arsyetuar siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Gjykata po ashtu konsideron se në rrethanat e rastit konkret zbatimi i drejtë i aspektit procedural që ka të bëjë me të drejtën për një vendim të arsyetuar mund ta afektojë aspektin material të kësaj kërkesë ashtu që të ketë epilog ndryshe në dobi të parashtruesit të kërkesës.
64. Gjatë vlerësimit të meritave të rastit nën shqyrtim, Gjykata do të zbatojë standardet e praktikës gjyqësore GJEDNJ-së, që në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar që të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë t'i interpretojë në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së.

Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar

65. Garancitë e mishëruara në nenin 6, paragrafin 1 të KEDNJ-së, përfshijnë edhe detyrimin e gjykatave që të paraqesin arsyetim të mjaftueshëm për vendimet e tyre. (shih, rastin e GJEDNJ-së, [H. kundër Belgjikës](#), nr. 8950/80, Aktgjykim i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53). Vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë.
66. Përkundër faktit që gjykata e brendshme ka një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe vendosjes për pranueshmërinë e dëshmive, ajo është e detyruar të justifikojë veprimet e saj duke arsyetuar të gjitha vendimet e saj (shih, rastet e GJEDNJ-së: [Suominen kundër Finlandës](#), nr. 37801/97, aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 36; si dhe rastin [Carmel Saliba kundër Maltës](#), nr. 24221/13, aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73).
67. Gjykata më e ulët ose autoriteti shtetëror, nga ana tjetër, duhet të japin arsye dhe arsyetime të tilla të cilat do t'u mundësojnë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive

- çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (shih: rastin e GJEDNJ-së [Hirvisaari kundër Finlandës](#), nr. 49684/99, i 25 dhjetorit 2001, paragrafi 30).
68. Neni 6 paragrafi 1 i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument (shih rastet e GJEDNJ-së, [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, aktgjykim i 29 janarit 1999, paragrafi 26; [Perez kundër Francës](#), nr. 47287/99, aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81).
69. Nga natyra e vendimit që merr gjykata varet nëse Gjykata është e detyruar ta arsyetojë atë, dhe kjo mund të vendoset vetëm në dritën e rrethanave të rastit në fjalë: është e nevojshme të merren parasysh, ndër të tjera, llojet e ndryshme të parashtrësive që një palë mund t'i paraqesë gjykatës, si dhe dallimet që ekzistojnë midis sistemeve juridike të vendeve në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, pozicionet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjytimeve (shih rastet e GJEDNJ [Ruiz Toria kundër Spanjës](#), nr. 18390/91, aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), nr. 18064/91, aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27).
70. Megjithatë, nëse parashtrësia e një pale është vendimtare për rezultatin e procedurës, ajo kërkon që t'i përgjigjet në mënyrë specifike dhe pa vonesë (shih rastet e GJEDNJ-së, [Ruiz Toria kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 30; Aktgjykimi [Hiro Balani kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 28).
71. Prandaj, gjykatat e brendshme janë të obliguara që:
- (a) të shqyrtojnë argumentet kryesore të palëve (shih rastet [Buzescu kundër Rumanisë](#), nr. 61302/00, aktgjykim i 24 gushtit 2005, paragrafi 67; [Donadze kundër Gjeorgisë](#), nr. 74644/01, aktgjykim i 07 qershorit 2006, paragrafi 35);
 - (b) të shqyrtohen me shumë rigorozitet dhe kujdes të veçantë kërkesat në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, KEDNJ dhe Protokollet e saj (shih rastet e GJEDNJ-së: [Fabris kundër Francës](#), cituar më lart, paragrafi 72; [Wagner dhe JMWL kundër Luksemburgut](#), nr. 76240/01, aktgjykim i 28 qershorit 2007, paragrafi 96).
72. Neni 6, paragrafi 1, nuk kërkon që Gjykata Supreme të japë një arsyetim më të detajuar kur ajo thjesht zbaton një dispozitë të caktuar ligjore lidhur me bazën ligjore për refuzimin e ankesës sepse ajo ankesë nuk ka një perspektivë për sukses (shih rastet e GJEDNJ-së, [Burg dhe të tjerët kundër Francës](#), nr. 34763/02; vendim i 28 janarit 2003; [Gorou kundër Greqisë](#) (nr. 2), nr. 12686/03, vendim i 20 marsit 2009, paragrafi 41).
73. Në mënyrë të ngjashme, në një rast ku bëhet fjalë për një kërkesë që të lejohet parashtrimi i ankesës, që është një parakusht për procedurën te një gjykatë më e lartë, si dhe për një vendim të mundshëm, neni 6, paragrafi 1, nuk mund të interpretohet në atë kuptim që të urdhëron një arsyetim të detajuar të vendimit për refuzimin e kërkesës për parashtrimin e ankesës (shih rastet e GJEDNJ-së, [Kukkonen kundër Finlandës](#) (nr. 2), nr. 47628/06, aktgjykim i 13 prillit 2009,) paragrafi 24; [Bufferne kundër Francës](#), nr. 54367/00, vendimi i 26 shkurtit 2002),
74. Përveç kësaj, kur refuzon një ankesë, gjykata e apelit, në parim, thjesht mund të pranojë arsyetimin e vendimit të dhënë nga gjykata më e ulët (shih rastin e GJEDNJ-së, [García Ruiz kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 26; shih, në kundërshtim me këtë, [Tatishvili kundër Rusisë](#), nr. 1509/02, aktgjykim i 09 korrikut 2007,) paragrafi

62). Megjithatë, koncepti i procedurës së drejtë nënkupton që gjykata vendase që ka dhënë një shpjegim të ngushtë për vendimet e saj, qoftë duke përsëritur arsyetimet e dhëna më parë nga një gjykatë më e ulët ose në ndonjë mënyrë tjetër, në fakt merrej me çështje të rëndësishme brenda juridiksionit të saj, që do të thotë se nuk i pranoi thjesht dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët (shih rastin [Helle kundër Finlandës](#), nr. (157/1996/776/977), aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60). Kjo kërkesë është aq më e rëndësishme nëse pala në kontest nuk ka pasur mundësi t'i paraqesë argumentet e saj gojarisht në procedurën para gjykatës vendase.

75. Megjithatë, gjykatat e apelit (në shkallën e dytë) të cilat kanë juridiksion për të hedhur poshtë ankesat e pabazuara dhe për të zgjidhur çështjet faktike dhe juridike në procedurën kontestimore, janë të obliguara të arsyetojnë se përse refuzuan të vendosin për ankesën (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Hansen kundër Norvegjisë](#), nr. 15319/09, aktgjykim i 2 janarit 2015, paragrafët 77–83).
76. Përveç kësaj, GJEDNJ nuk përcaktoi se ishte shkelur e drejta në një rast në të cilin nuk është dhënë një sqarim specifik në lidhje me një pohim që i referohej një aspekti të parëndësishëm të rastit, përkatësisht mungesës së nënshkrimit dhe vulës, që është një gabim i një natyre më shumë formale sesa materiale dhe ai gabim u korrigjua menjëherë (shih rastin e GJEDNJ-së, [Mugoša kundër Malit të Zi](#), nr. 76522/12, aktgjykim i 21 shtatorit 2016, paragrafi 63).

Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

77. Gjykata rithekson se nuk është detyra e saj që t'i zëvendësojë gjykatat e rregullta, që janë në pozitë më të mirë për t'i vlerësuar provat në dispozicionin e tyre, t'i konstatojnë faktet dhe interpretojnë të drejtën vendore (shih, për shembull, rastin e GJEDNJ-së, [Khamidov kundër Rusisë](#), nr. 72118/01, Aktgjykim i 15 nëntorit 2007, paragrafi 170). Gjykata thekson se kur bëhet fjalë për konstatimin e fakteve dhe interpretimin e ligjit, është e “ndjeshme” për natyrën subsidiare të rolit të saj dhe se duhet të jetë e kujdesshme në marrjen e rolit të gjykatës së faktit, veçse kur një gjë e tillë është bërë e pashmangshme nga rrethanat e rastit (shih, për shembull, rastin e GJEDNJ-së, [Bărbulescu kundër Rumanisë](#), nr. 61496/08, Aktgjykim i 2017, paragrafi 129).
78. Nevoja e Gjykatës për ta marrë këtë rol në rastin konkret përforcohet edhe nga parimi se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 (1) i KEDNJ-së sikurse edhe Kushtetuta dhe KEDNJ-ja si tërësi, duhet të interpretohen ashtu që të garantojnë të drejta që janë praktike dhe efektive dhe jo teorike apo të rreme (shih, mes tjerash, rastin e GJEDNJ-së, [Vistiņš dhe Perepjolkins kundër Letonisë](#), nr. 71243/01, Aktgjykim i 25 tetorit 2012, paragrafi 114).
79. Gjykata thekson se në praktikën e saj gjyqësore në shumë raste ka konstatuar se çështjet e faktit dhe çështjet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit janë brenda fushëveprimit të gjykatave të rregullta dhe të autoriteteve të tjera publike, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe si të tilla janë çështje të ligjshmërisë, përveç dhe përderisa, çështje të tilla rezultojnë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ose krijojnë një situatë antikushtetuese (shih, mes tjerash, Gjykata Kushtetuese Rasti nr. [KI33/16](#), parashtruese [Minire Zeka](#), Aktgjykim i 4 gushtit 2018, paragrafi 91). Pavarësisht nga hapësira e vlerësimit të gjykatave të rregullta, vendimi përfundimtar lidhur me respektim të kritereve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së ngelet tek Gjykata Kushtetuese (shih dispozitat e neneve 4 paragrafi 6 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe 112 paragrafi 1 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës;

dhe po ashtu, shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, [Konstantin Markin kundër Rusisë](#), nr. 30078/06, Aktgjykim i 22 marsit 2012, paragrafi 126).

80. Gjykata vëren se bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të GJEDNJ-së, nuk mund të ketë justifikim që neni 6 (1) i KEDNJ-së të interpretohet në mënyrë të kufizuar (shih rastin e GJEDNJ-së, *Moreira de Azevedo kundër Portugalisë*, nr. 11296/84, Aktgjykim i 23 tetorit 1990, paragrafi 66). Kriteret e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm janë të vlefshme për procedurat në tërësi (shih rastin e GJEDNJ-së, [Stran Greek Refineries dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë](#), nr. 13427/87, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 49). Rrjedhimisht, procedurat shqyrtohen në tërësi në mënyrë që të vërtetohet nëse ato janë zhvilluar në pajtim me kriteret e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm (shih rastin e GJEDNJ-së, [De Tommaso kundër Italisë](#), nr. 43395/09, Aktgjykim i 23 shkurtit 2017, paragrafi 172). Mungesa e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm mund të rezultojë nga një sërë faktorësh të rëndësishëm të ndryshme (shih rastin e GJEDNJ-së, [Carmel Saliba kundër Maltës](#), nr. 24221/13, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 79, lidhur me kriterin për të dhënë arsyetim).

Aspekti res judicata i largimit të kundërligjshëm nga puna dhe kthimi në vendin e punës të parashtruesit të kërkesës

81. Si çështje paraprake të këtij rasti, Gjykata vlerëson se anulimi dhe shpallja të kundërligjshëm të njoftimit të të paditurës Pro CreditBank të 15 dhjetorit 2010 për largim nga puna të parashtruesit të kërkesës dhe kthimi i të njëjtit në vendin e mëparshëm të punës tek e paditura Pro Credit Bank janë çështje të gjykuara *res judicata* të vërtetuara me Aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Pejë [C. nr. 2569/11] të 14 dhjetorit 2012 dhe Aktgjykimin të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 1955/13] të 27 qershorit 2016.
82. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata do të vlerësojë nëse gjykatat e rregullta kanë arsyetuar në pajtim me standardet e përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së aspektet qendrore të rastit të parashtruesit të kërkesës që ndërlidhen: **(i)** periudhën prej 15 dhjetor 2010 (dita e largimit nga puna të parashtruesit të kërkesës) deri 31 gusht 2012 lidhur me realizimin e të ardhurave personale të papaguara dhe kërkesave tjera aksesore nga marrëdhënia e punës; **(ii)** periudhën prej 1 shtatorit 2012 deri 30 shtator 2016, gjatë së cilës periudhë parashtruesi i kërkesës kishte realizuar të ardhura personale në kompaninë regjionale "Ambienti" sh.a., derisa nuk ishte kthyer në vendin e mëparshëm të punës tek e paditura Pro Credit Bank.

Periudha kontestuese 15 dhjetor 2010 deri 31 gusht 2012

83. Lidhur me periudhën 15 dhjetor 2010 deri 31 gusht 2012, Gjykata vëren se Gjykata Komonale në Pejë (Aktgjykim C.nr.2569/11) i ka akorduar parashtruesit të kërkesës të ardhurat personale të porealizuara së bashku me kërkesat tjera aksesore nga marrëdhënia e punës. Mirëpo, në fazat e mëtejme të zhvilluara në të gjitha instancat tjera më të larta gjyqësore, periudha 15 dhjetor 2010 deri 31 gusht 2012, nuk është trajtuar fare.
84. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se shpërfillja e tërësishme nga gjykatat e rregullta të periudhës 15 dhjetor 2010 deri 31 gusht 2012 lidhur me të ardhurat personale të porealizuara dhe kërkesat tjera aksesore nga marrëdhënia e punës, është aspekt i rëndësishëm i kërkesës së parashtruesit të kërkesës. E drejta për një vendim të arsyetuar kërkon që çështjet qendrore të një rasti të shqyrtohen seriozisht nga gjykatat e rregullta dhe jo që mos trajtohen fare, siç ka ndodhur në rastin konkret. Aq më tepër,

kur parashtruesi i kërkesës në vazhdimësi në të gjitha instancat gjyqësore, mes tjerash, kishte kërkuar edhe vlerësimin e periudhës 15 dhjetor 2010 deri 31 gusht 2012.

85. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se shpërfillja e tërësishme nga gjykatat e rregullta të periudhës 15 dhjetor 2010 deri 31 gusht 2012 lidhur me të ardhurat personale të përealizuara dhe kërkesat tjera aksesore nga marrëdhënia e punës të parashtruesit të kërkesës, bie ndesh me garancitë procedurale nga paragrafi 1 i nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

Periudha kontestuese prej 31 gushtit 2012 deri 30 shtator 2016

86. Gjykata përsërit se periudha 31 gusht 2012 deri 30 shtator 2016, ndërlihet me punësimin e parashtruesit të kërkesës në kompaninë regjionale "Ambienti" sh.a., dhe të ardhurat që i kishte realizuar aty. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës-në mënyrë efektive- ishte kthyer në vendin e mëparshëm të punës Zyrtar Kreditore tek e paditura Pro Credit Bank më 3 tetor 2016.
87. Prandaj, Gjykata konsideron se periudha 31 gusht 2012 deri 30 shtator 2016 është aspekt qendror i kërkesës së parashtruesit të kërkesës që është dashur të shqyrtohet seriozisht nga gjykatat e rregullta sepse ndërlihet me kalkulimin e drejtë të të ardhurave personale dhe kërkesave tjera aksesore të parashtruesit të kërkesës duke qenë i angazhuar në kompaninë regjionale "Ambienti" sh.a., në njërin anë, dhe mos realizimi i të ardhurave personale dhe kërkesave tjera aksesore derisa parashtruesi i kërkesës nuk është kthyer në mënyrë efektive në vendin e mëparshëm të punës tek e paditura Pro Credit Bank më 3 tetor 2016.
88. Gjykata vëren se Gjykata Themelore (Aktgjykim C.nr.1507/16 dt.22.10.2018) lidhur me punësimin e parashtruesit të kërkesës në kompaninë regjionale "Ambienti" sh.a., gjatë periudhës kontestuese, ishte shprehur: *"Me rastin e vendosjes së kërkesëpadisë, gjykata ka marrë për bazë edhe të ardhurat që paditësi ka realizuar paraprakisht në institucionet publike, konkretisht në kompaninë regjionale të mbeturinave "Ambienti" sh.a., ku të ardhurat e realizuara nga kjo kompani për periudhën kontestuese janë reduktuar në të ardhurat në emër të pagave për paditësin."*
89. Gjykata si pikë e parë vlerëson se është legjitime dhe juridikisht e qëndrueshme që pagat e përealizuara të parashtruesit të kërkesës gjatë periudhës kontestuese (31 gusht 2012 deri 30 shtator 2016) të krahasohen dhe reduktohen në proporcion me pagat që parashtruesi i kërkesës i ka realizuar gjatë punësimit në kompaninë regjionale "Ambienti" sh.a. Për Gjykatën kjo çështje në vetvete nuk është kontestuese dhe nuk ngre çështje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Mirëpo, po ashtu, për Gjykatën është e papranueshme mënyra sesi gjykatat e rregullta kanë adresuar këtë çështje e cila për mënyrën e arsyetimit ose thënë më mirë mos arsyetimit të saj-në fakt dhe në të vërtetë-ngre çështje të të drejtave dhe lirive themelore individuale.
90. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta nuk kanë treguar: (i) sa ka qenë paga që ka realizuar parashtruesi i kërkesës në kompaninë regjionale "Ambienti" sh.a.; (ii) cili ka qenë dallimi i saktë i pagave që parashtruesi i kërkesës ka realizuar gjatë periudhës kontestuese pranë kompanisë regjionale "Ambienti" sh.a., në krahasim me të ardhurat personale të përealizuara tek e paditura Pro Credit Bank; (iii) cili është reduktimi i saktë gjatë periudhës kontestuese përkatësisht gjatë angazhimit të parashtruesit të kërkesës në kompaninë regjionale "Ambienti" sh.a. kundrejt të ardhurave të përealizuara tek e paditura Pro Credit Bank.

91. Gjykata vlerëson se shpjegimi i dhënë nga gjykatat e rregullta tregon mungesë evidente të reduktimit të saktë e të kuptueshëm të të ardhurave personale të porealizuara të parashtruesit të kërkesës tek e paditura Pro Credit Bank në krahasim me pagat e realizuara të të njëjtit pranë kompanisë regjionale “Ambienti” sh.a., lidhur me periudhën kontestuese 31 gusht 2012 deri 30 shtator 2016.
92. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se arsyetimi deficitar i dhënë nga gjykatat e rregullta përkitazi me reduktimin e shumës së pagave të porealizuara të parashtruesit të kërkesës gjatë periudhës kontestuese (31 gusht 2012 deri 30 shtator 2016) bie ndesh me të drejtën për një vendim të arsyetuar siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së.
93. Për sa i përket pretendimeve për gjykatë të paanshme të themeluar me ligj, gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe administrim të drejtë të drejtësisë si dhe nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se këto pretendime nuk ngrenë ndonjë çështje të re që nuk është shqyrtuar më parë dhe se të njëjtat janë konsumuar me konstatim të shkëljes të së drejtës për një vendim të arsyetuar siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në kombinim me nenin 6 (1) të KEDNJ-së (shih rastin e Gjykatës [KI193/18](#), parashtrues *Agron Vula*, Aktgjykim i 22 prillit 2020, paragrafi 145 dhe referencat e përmendura aty).

Përfundim për tërë periudhën kontestuese nga 15 dhjetori 2010 deri më 30 shtator 2016

94. Gjykata vlerëson se shpjegimi i dhënë nga gjykatat e rregullta tregon mungesë të dukshme të një shpjegimi të saktë dhe të kuptueshëm të shumës së të ardhurave personale të porealizuara të parashtruesit të kërkesës me të paditurën Pro Credit Bank për tërë periudhën kontestuese nga 15 dhjetori 2010, kur u ndërpre marrëdhënia e punës së parashtruesit të kërkesës në mënyrë të paligjshme deri më 30 shtator 2016, kur parashtruesi i kërkesës është kthyer në vendin e punës te e paditura Pro Credit Bank me vendim të gjykatës. Gjithashtu, gjykatat e rregullta nuk kanë arsyetuar sa ishin shumat e reduktuara, përkatësisht realizimit të të ardhurave të parashtruesit të kërkesës në kompaninë rajonale “Ambienti” sh.a.
95. Për të gjitha sa më sipër, Gjykata konkludon se gjykatat e rregullta nuk kanë shpjeguar me një fjalë të vetme pse parashtruesi i kërkesës nuk ka të drejtë në të ardhurat personale të porealizuara me të paditurën Pro Credit Bank për periudhën kontestuese nga 15 dhjetori 2010 deri në 31 gusht 2012, si dhe pse parashtruesi i kërkesës fiton të drejtën e kompensimit për të ardhurat personale të papaguara nga 31 gushti 2012 deri më 30 shtator 2016, edhe pse ishte vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme se parashtruesit të kërkesës i ishte ndërprerë në mënyrë të kundërligjshme marrëdhënia e punës më 15 dhjetor 2010, gjë që u bë çështje *res judicata* e vërtetuar me aktgjykimin [C. nr. 2569/11] të Gjykatës Komonale në Pejë të 14 dhjetorit 2012 dhe me aktgjykimin [Ac. nr. 1955/13] të Gjykatës së Apelit të 27 qershorit 2016.

Lidhur me pretendimet tjera të parashtruesit të kërkesës

96. Lidhur me pretendimet tjera të parashtruesit të kërkesës për kërkesat aksesore nga marrëdhënia e punës që ndërlidhen me dyfishin e kompensimit të të ardhurave personale të porealizuara, zbritjen e trustit pensional, tatimi i të ardhurave personale, diskriminimi në lartësi të pagës në krahasim me kolegët tjerë, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit (Aktgjykim Ac. nr. 504/19, dt.13.10.2021) kishte arsyetuar: **(i)** Gjykata e Apelit thekson se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar dispozitat e nenit 80.1.1 dhe 1.2. të Ligjit të punës, sepse këto dispozita nuk mund të zbatohen në mënyrë kumulative por alternative dhe varësisht nga rrethanat e zbaton vetëm njërin prej paragrafëve të nenit 80 të ligjit të punës; **(ii)** sepse sipas Gjykatës së Apelit,

gjkata e shkallës së parë është dashur ose të urdhërojë kompensimin e dyfishtë të pagave që takon gjatë kohës së largimit nga puna, ose të urdhërojë kthimin e parashtruesit në punë dhe kompensimin e të gjitha pagave dhe përftimeve të humbura gjatë kohës së largimit të paligjshëm nga puna; **(iii)** logjikisht dhe juridikisht parashtruesi i kërkesës është dëmtuar vetëm për ato paga që i njëjti do të kishte mundësi t'i realizonte sikur të mos i ndërpritej marrëdhënia e punës; dhe, se (iv) gjykatat e rregullta në përgjithësi në rastin e parashtruesit të kërkesës kanë shqyrtuar kërkesat aksesore nga marrëdhënia e punës që ndërlidhen me zbritjen e trustit pensional, tatimi i të ardhurave personale, diskriminimi në lartësi të pagës në krahasim me kolegët tjerë.

97. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për diskriminim në pagë në krahasim me kolegët tjerë, Gjykata vëren se Gjykata Supreme (Aktgjykim Rev.nr.103/2022, dt. 30.03.2022) kishte arsyetuar: **(i)** Gjykata Supreme thekson se diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuar në nenin 1 të ligjit për mbrojtje nga diskriminimi që kanë të bëjnë me veçoritë e pretenduesit të diskriminimit; **(ii)** kurse në rastin konkret, me aktgjykimet e kontestuara të gjykatave të instancës më të ulët është shpallur i paligjshëm vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe është obliguar e paditura që parashtruesin e kërkesës ta kthej në punë.
98. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për kërkesat aksesore nga marrëdhënia e punës që ndërlidhen me dyfishin e kompensimit, diskriminim, zbritjen e trustit pensional dhe tatimi i të ardhurave personale, janë qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese, dhe se duhet të shpallen të papranueshme në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës (shih përshtatshmërisht, rastin e GJEDNJ-së, [Toziczka kundër Polonisë](#), nr. 29995/08 Aktgjykim i 24 korrikut 2012, paragrafët 48-49).
99. Gjykata po ashtu konsideron se pretendimi për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së nuk mund të jetë objekt i vlerësimit kushtetues, për shkak se i njëjti nuk ngre ndonjë çështje të re që nuk është shqyrtuar në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së (shih, mutatis mutandis, rastet e Gjykatës nr. [KI65/15](#), parashtrues *Tatjana Davila, Ljubiša Marić, Zorica Kršenković, Zlatoj Jevtić*, Aktgjykim i 14 shtatorit 2016; dhe nr. [KI193/18](#), parashtrues *Agron Vula*, Aktgjykim i 22 prillit 2020).

Përfundim

100. Gjykata përfundon se në rastin konkret ka konstatuar shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar si një nga komponentët e të drejtës së përgjithshme për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm që garanton drejtësi procedurale të mishëruar në paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës dhe në paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.
101. Gjykata rithekson se e drejta për një vendim të arsyetuar kërkon që pretendimeve thelbësore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës në gjykatat e rregullta duhet dhënë përgjigje në mënyrën e duhur, posaçërisht nëse kanë të bëjnë me pretendimet vendimtare që në rastin konkret i referohen (i) periudhës kontestuese 15 dhjetor 2010 deri 31 gusht 2012 lidhur me të ardhurat personale të porealizuara dhe kërkesat tjera aksesore nga marrëdhënia e punës të parashtruesit të kërkesës; si dhe (ii) periudha kontestuese 31 gusht 2012 deri 30 shtator 2016 që ndërlidhet me llogaritjen e drejtë të reduktimit të ardhurave personale dhe kërkesave tjera aksesore të parashtruesit të kërkesës për kohën sa ka qenë i angazhuar në kompaninë regjionale "Ambienti" sh.a.

102. Nga sa më sipër, Gjykata u vë obligim gjykatave të rregullta-që në rigjykimin e kësaj çështjeje-në mënyrë të saktë dhe pa dykuptimësi të konstatojnë dhe akordojnë: (i) shumën e kompensimit të të ardhurave personale të porealizuara të parashtruesit të kërkesës për periudhën kontestuese 15 dhjetor 2010 deri 31 gusht 2012; (ii) shumën e kompensimit të të ardhurave personale të porealizuara të parashtruesit të kërkesës për periudhën kontestuese 31 gusht 2012 deri 30 shtator 2016, në përputhje me parimin e efektshmërisë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut siç garantohen me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.
103. Gjykata po ashtu rithekson se çështja e anulimit dhe shpallja të kundërligjshëm të njoftimit të të paditurës Pro Credit Bank të 15 dhjetorit 2010 për largim nga puna të parashtruesit të kërkesës dhe kthimi i të njëjtit në vendin e mëparshëm të punës tek e paditura Pro Credit Bank janë çështje të gjykuara *res judicata*, të vërtetuara me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Pejë [C. nr. 2569/11] të 14 dhjetorit 2012 dhe Aktgjykimin të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 1955/13] të 27 qershorit 2016. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se këto çështje nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i serishëm nga gjykatat e rregullta gjatë rigjyimit të urdhëruar me këtë aktgjykim.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113 (1) dhe (7) dhe 116 (1) të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 7 qershor 2023, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të paragrafit 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË KONSTATOJË se Aktgjykimi [Ac. nr. 1955/13] i Gjykatës së Apelit i 27 janarit 2016, lidhur me anulimin e njoftimit të 15 dhjetorit 2010 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës lidhur me kthimin në vendin e mëparshëm të punës, është *res judicata*;
- IV. TË SHPALLË të pavlefshëm, Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 103/2022] të 30 marsit 2022, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 504/19] të 13 tetorit 2021 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë [C. nr. 1507/16] të 22 tetorit 2018;
- V. TË KTHEJË, çështjen për rishqyrtim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;
- VI. TË URDHËROJË Gjykatën Themelore në Prishtinë që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, deri më 18 dhjetor 2023, për masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi të Gjykatës;
- VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VIII. TË KONSTATOJË që Aktgjykimi hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani